



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
KRYETARI

Nr. 4087 prot.

Himarë, më 02.06.2025

**Lënda:** Shkresë përcjellëse e projekt vendimit mbi disa ndryshimeve ne Buxhetin faktik për vitin 2025 të Bashkisë Himarë.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË,

këtu ✓

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore”, Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 03.4.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik” i ndryshuar, të Ministrisë së Financave.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

projekt vendimin mbi disa ndryshimeve ne Buxhetin faktik për vitin 2025 të Bashkisë Himarë.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

**KRYETARI**  
**VANGJEL TAVO**

**Përgjegjës i Sektorit Juridik.**  
**Alban SAQELLARI**



**DREJTOR**  
**Themistokli FOTO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KRYETARI**

Nr. 4087 / Prot

Datë 02/06 / 2025

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 25, date 02/06 / 2025

**(Per miratimin e disa ndryshimeve ne Buxhetin faktik për vitin 2025 të Bashkisë Himarë)**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, date 17.12.2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”, Neni 54, pika “dh”, Ligjit nr.9936,date 26.06.2008 „Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise”,i ndryshuar, Ligjit Nr.115,date 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhezimit plotesues te Ministrise se Financave nr.2, date 24.01.2025 Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025,Kreu II, Vendimit te Këshillit të Bashkisë Himarë nr.39, date 20.12.2024 “Per krijimin e Ndërmarjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në vartësi të Bashkisë Himarë”,pika 4, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Himarë nr.14, datë 02.04.2025 “Për miratimin e Buxhetit Faktik të Bashkisë Himarë viti 2025”, pika 4,shprehur ligjshmeria nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresë nr.400/3 prot, date 18.04.2025, me propozim të Ndërmarjes së Shërbimeve Publike Himarë , Keshilli i Bashkise Himarë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimet buxhetore në buxhetin faktik të Bashkisë Himarë viti 2025 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtoria zhvillimit ekonomik, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Keshilli Bashkiak sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave .
3. Ndryshimet të pasqyrohen në PBA 2025- 2027.
4. Ndryshimet qe prekin buxhetin e NSHP te pasqyrohen ne VKB nr 39 date 24.12.2024
5. Ndryshimet mbi numrin e punonjesve te pasqyrohen ne Vendimin nr 40 dt. 24.12.2024
6. Efektet financiare nisin sipas legjislacionit ne fuqi.

**KRYETARI**

**Vangjel Tavo**



Ne Buxhetin e Ndërmarjes së Shërbimeve Publike Himarë per vitin 2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Himarë nr.39, date 20.12.2024 “Per krijimin e Ndërmarjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në vartësi të Bashkisë Himarë,pika 4, si dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Himarë nr.14, datë 02.04.2025 “Për miratimin e Buxhetit Faktik të Bashkisë Himarë viti 2025”, pika 4,shprehur ligjshmeria nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresë nr.400/3 prot, date 18.04.2025, te behen ndryshimet sa me poshte vijon:

➤ **Fondet e parashikuara për:**

- “Përmisimi i aksesibilitetit në godinat publike” me vlerë 2,000,000 lekë,artikulli 231
- “Mirëmbajtje e kamerave të godinave dhe rrugore” me vlerë 1,000,000 lekë, artikulli 602.

Si dhe diferencat e krijuara nga procedurat e prokurimit të realizuara për objektet:

- Shpenzime për pastrimin e Nj.A Himarë-Horë-Vranisht me vlerë 875,000 lekë,artikulli 602.
- Shpenzime për pastrimin e Nj.A Lukovë me vlerë 4,477,000 lekë, artikulli 602.

**Të përdoren për:**

- Blerje kamjonçinë me vlerë 3,500,000 lekë, artikulli 231.
- Shpenzime për programin financiar menaxherial dhe fiskal të NSHP-së me vlerë 1,000,000 lekë, artikulli 602
- Shpenzime për veshje,paisje dhe vegla pune me vlerë 3,852,000 lekë

- Ritjen e numrit të punonjësve në organigramën e Ndërmarjes së Shërbimeve Publike Himarë me 7 (shtatë) punonjës sezonal, shpenzimet administrative për këta punonjës do të përballohen nga buxheti i parashikuar për NSHP-në artikujt 600 dhe 601.
- Shpenzime për marrjen me qera të automjeteve për nevojat e institucionit (leasing) bëhet Blerje automjesh, për nevojshmeritë e institucionit

**Përgjegjës i Sektorit të Financës**

**Artemis KITO**

**Përgjegjës i Sektorit Juridik.**


**Alban SAQELLARI**

**KRYETAR I BASHKISË**

**Vangjel TAVO**

**DREJTOR**

**Themistokli FOTO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**NDËRMARJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE HIMARË**

Nr. 4087/2 / Prot

Datë 02.10.2025 / 2025

**RELACION**

**(Per miratimin e disa ndryshimeve ne Buxhetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2025)**

Projekt vendimi qe paraqitet per miratim nis nga fakti se ne buxhetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2025, te miratuar me vendimin e Keshillit te Bashkise Himarë nr.39, date 20.12.2024 “Per krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në vartësi të Bashkisë Himarë,pika 4, si dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Himarë nr.14, datë 02.04.2025 “Për miratimin e Buxhetit Faktik të Bashkisë Himarë viti 2025”, pika 4,janë të domosdoshëm disa ndryshime, kjo në funksion të nevojave që na paraqiten në këtë vit të parë të përvojës sonë, e konkretisht:

1. Nisur nga prioritetet dhe elementët e domosdoshëm të ecurisë normale të kryerjes së funksioneve të NSHP-së gjykojme se fondet e parashikuara për:

- “Përmisimi i aksesibilitetit në godinat publike” me vlerë 2,000,000 lekë,artikulli 231
- “Mirëmbajtje e kamerave të godinave dhe rrugore” me vlerë 1,000,000 lekë, artikulli 602.

Si dhe fondet e krijuara nga diferencat e prokurimeve ( vlerat e parashikuara dhe vlerat e kontraktuara pas përfundimit të procedurave të prokurimit) të objekteve:

- Shpenzime për pastrimin e Nj.A Himarë-Horë-Vranisht me vlerë 875,000 lekë
- Shpenzime për pastrimin e Nj.A Lukovë me vlerë 4,477,000 lekë

Në një total të përgjithshëm prej 8,352,000 lekë, të përdoren për:

- Blerje kamjonçinë me vlerë 3,500,000 lekë, artikulli 231.
  - Shpenzime për programin financiar menaxherial dhe fiskal të NSHP-së me vlerë 1,000,000 lekë,artikulli 602.
  - Shpenzime për veshje paisje dhe vegla pune me vlerë 3,852,000 lekë, artikulli 602.
- Shpenzime këto të pa parashikuar në buxhet, por që janë mjaft të nevojshme për ndërmarrjen tonë.

Ndryshimet e sipërpërmendura të cilat legjitimohen nga Ligji nr. 139/2015, date 17.12.2015 "Per Vetqeverisjen Vendore", Neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e keshillit bashkiak", pika "dh" në të cilën citohet "miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njërive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë", kërkohen për faktin e thjeshte sepse "Mirëmbajtje e kamerave të godinave dhe rrugore" është e parashikuar njëkohësisht edhe në Buxhetin e Bashkisë Himarë dhe në buxhetin e NSHP-së, ndërsa "Përmisimi i aksesibilitetit në godinat publike" nuk shihet si domosdoshmëri nga ana e jonë për tu realizuar gjatë këtij viti, pasi NSHP-ja , nisur nga sensibilitetet e komunitetit për shërbime, që janë pjesë e funksionit të saj, shih si prioritete burimet njerëzore, makineritë , veglat ,pajset dhe materialet e ndryshme, të cilat mundësojnë realizimin me sukses të misionit të saj.

Konkretisht për të bërë të mundur këtë, kërkohet që përveç vlerave të dy objekteve të cituara më sipër, të përdoren dhe diferencat e krijuara ndërmjet vlerave të programuara dhe vlerave të kontraktuara pas përfundimit të procedurave të prokurimit për objektet "Shpenzime për pastrimin e Nj.A Himarë-Horë-Vranisht" dhe "Shpenzime për pastrimin e Nj.A Lukovë", brenda buxhetit të NSHP-së, pa rënduar buxhetin e Bashkisë Himarë.

Shuma e krijuar në masën 8.352.000 lekë do të përdoret për çka tham më sipër duke realizuar kështu ritjen e cilësisë së shërbimeve që NSHP-ja do tu afrojë banorëve të Bashkisë Himarë. Vlerat e objekteve të mallrave apo shërbimeve të cilat kemi kërkuar për miratim, janë përlllogaritur në funksion të sasisë, parametrave dhe cilësisë së kërkuar për to, duke testuar tregun.

2. Ritja e numrit të punonjësve në organigramën e NSHP-së me 7 (shtatë) punonjës sezonal vjen nga nevoja që paraqiten gjatë ushtrimit të funksioneve tona në periudhën e sezonit turistik. Nga përlllogaritjet e kryara nga ana e jonë duke parë fondet e programuara për shpenzime personeli artikulli 600 dhe 601 si dhe fondet e realizuara deri me date 31.05.2025, fondet e mbetura janë të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve të personelit aktual të NSHP-së , si dhe atyre që kërkohet për punësim sezonal deri në fund të këtij viti buxhetor.

Miratimi i ketyre ndryshimeve ne Buxhetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë per vitin 2025, paraqet një domosdoshmëri për të siguruar nje ecuri normale të kryerjes së funksioneve nga ana e NSHP-së, e për këtë shprehim besimin tonë në miratimin e këtij projekt vendimi nga ana e juaj.

**Përgjegjës i Sektorit të Finances**

**Artemis KITO**